



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME  
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr.02/ 416

Datë: 17.7.2019

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008, datë 04.06.2008, nenin 44 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e Komunës së Shtimes, si dhe në bazë të Rregullores ( QRK ) Nr.13/2017 për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, Strategjisë Shtetërore për Ri-integrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2018-2022 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Ri-integrimi të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar ( 2018-2020 ), Kryetari i Komunës, më datë 18.07.2019, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Themelohet Grupi Punues për hartimin e Planit Komunal për Ri-integrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar, në këtë përbërje:**

1. Ibrahim Demiri - Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, kryesues i Grupit Punues
2. Jener Fazliu - DSHMS - Qendra për Punë Sociale
3. Adem Ramadani - Drejtoria për Shërbime Publike
4. Besnik Shala – Drejtoria Komunale për Arsim
5. Sami Jonuzi – Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
6. Selvishahe Bajrami- Zyra e Punësimit
7. Reshat Gashi - Koordinator për drejta të njeriut dhe barazi gjinore
8. Driton Halili – Zyrtar i Lartë për Koordinim Rajonal të Ri-integrimit në DRPR-MPB

**II.**Grupi Punues, sipas Pikës së Parë të këtij Vendimi, obligohet që të ndërmarrë të gjitha veprimet për hartimin e Planit Komunal për Ri-integrim të Qëndrueshëm në përputhje me kërkesat dhe nevojat e ri-integrimit të Personave të Riatdhesuar, në komunë.

**III.**Obligohen të gjitha Drejtoritë, Sektorët dhe Zyrat Komunale që t'i ofrojnë mbështetje Grupit Punues.

**IV.** Për punën që do të kryej, ky Grup Punues, i përgjigjet Kryetarit të Komunës.

**V.** Vendimi hynë në fuqi në ditët e marrjes.

Vendimi i dërgohet:

1. Anëtarëve të Grupit Punues;
2. Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal;
3. Ministrisë për Punë të Brendshme
4. Arkivit

